Risku operacional është risku i humbjes financiare të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë që vjen si rezultat i një sërë shkaqesh të lidhura me papërshtatshmërinë ose dështimin e proçeseve, personelit, teknologjisë dhe infrastrukturës së Bankës, ashtu si edhe nga faktorë të jashtëm. Objektivi i Bankës është të mbulojë humbjet e pritshme dhe të papritshme që burojnë nga risqet operacionalë.

Drejtimi i riskut operacional bëhet në përputhje me politikat e proçedurat e brendshme të Bankës, si edhe në përputhje me kërkesat e rregullores Nr. 03 datë 19/01/2011 “Për administrimin e rrezikut operacional”.

Në përputhje me kuadrin e brendshëm dhe atë rregullator, Banka ka zhvilluar proçedura dhe sisteme të cilat bëjnë të mundur identifikimin, vlerësimin dhe raportimin e ngjarjeve të riskut operacional. Në vijim të këtij raportimi, bëhet klasifikimi i humbjeve bruto sipas linjave të biznesit si dhe analiza të mëtejshme. Gjithashtu, Banka ka zhvilluar edhe një raportim mujor të disa treguesve kyç të riskut operacional, të cilat raportohen periodikisht pranë Bankës së Shqipërisë.

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2021 ka vijuar projekti vjetor i Kontrollit të Riskut përmes proçesit të Vet-vlerësimit të njësive të bankës. Rezultatet dhe plani i veprimit analizohen periodikisht gjatë prezantimeve në Komitetin përkatës të Riskut Operacional, në kuadër të forcimit të mëtejshëm të masave parandaluese dhe atyre të zbutjes së riskut operacional.

Banka ka miratuar një proçedurë të veçantë për vlerësimin e çështjeve ligjore ku ajo mund të jetë e përfshirë, duke i paraprirë risqeve që burojnë nga ato.

Përveç procesit të përvitshëm të Kontrollit të Riskut me metodën e Vet-vlerësimit dhe pjesëmarrjen e të gjitha njësive, banka ka kryer për të dytin vit rradhazi edhe atë të Vet-vlerësimit të veprimtarive outsource të saj për vlerësimin e rrezikut të jashtëm.

Banka përdor metodën e treguesit të thjeshtë për të llogaritur kërkesat për kapital për të mbuluar riskun operacional. Kjo metodë konsideron të ardhurën neto nga veprimtaria bankare për tre vitet e fundit të veprimtarisë së bankës dhe një koeficient prej 15%.

Nr.		Zëri	Shuma (000 lekë)
		RREZIKU OPERACIONAL	
310	3	Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezik për rrezikun operacional	4,469,357
320	3.1	Metoda e Treguesit Bazik (BIA)	4,469,357

(d) Risku i kredisë

Drejtimi i riskut të kredisë bëhet në përputhje me politikat e brendshme të Bankës si edhe në përputhje me rregulloren e Bankës së Shqipërisë Nr. 62 datë 14/09/2011 – e rishikuar “Për administrimin e rrezikut të kredisë”. Banka e drejton ekspozimin e saj ndaj riskut të kredisë në mënyrë periodike duke monitoruar nga afër respektimin e limiteve të kredisë, portofolin e huave dhe cilësinë e tij dhe përqëndrimin e ekspozimit.

Banka i ka kushtuar një vëmendje të veçantë riskut të kredisë duke e zhvilluar në shkallën e duhur që të mund të identifikojë, vlerësojë dhe monitorojë atë, me qëllim mbajtjen e ekspozimeve në nivele të kënaqshme bankingu me pakicë si dhe në nivel korporatash. Në strukturën e saj organizative, Banka ka zhvilluar struktura të ndryshme të cilat kanë përgjegjësi të mirëpërcaktuara qysh në fillimet e procesit të aplikimit për kredi, duke vijuar më tej me analizën dhe paraqitjen e aplikimit në komitetet përkatëse. Proçesi i analizës dhe miratimit i nënshtrohet parimit të katër syve si nga njësitë e biznesit ashtu edhe nga ato të kreditit. Proçesi i monitorimit në vazhdimësi kryhet nga njësitë përkatëse e përmendura më sipër, si dhe nga njësia e menaxhimit të riskut për portofolin në tërësi. Gjithashtu, Banka ka zhvilluar dhe njëkohësisht përdor përgjatë procesit të miratimit të kredisë teknikat e klasifikimit të brendshëm. Më konkretisht, Banka përdor modele të klasifikimit të brendshëm për klientët e biznesit, si dhe modele të pikësimit për produktet ofruar klientëve individë.

Në përputhje me metodologjinë e Bankës të gjitha ekspozimet e huave janë të klasifikuara si ekspozime përformuese dhe me probleme. Banka klasifikon portofolin e ekspozimeve duke u bazuar në Rregulloren Nr. 62 “Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja”. Këto rregulla përfshijnë faktet objektive si: shkelja e kontratës, moskryerja e pagesave të interesit dhe principalit; vështirësi financiare të huamarrësit; dhe informacione të tjera të rëndësishme financiare për klientin, sipas industrisë dhe llojin e produktit.

Banka përcakton një fond për humbjet nga zhvlerësimi i kredive që përfaqëson një përlllogaritje për humbjet në portofolin e kredive. Për çdo kategori të rrezikut Banka përlllogarit fonde rezervë në përputhje me Rregulloren Nr. 62 të Bankës së Shqipërisë “Mbi Administrimin e Rrezikut të Kredisë”.

Drejtimi i riskut të kredisë bëhet në përputhje me politikat e brendshme të Bankës dhe të Grupit si edhe në përputhje me rregulloren e Bankës së Shqipërisë Nr. 62 datë 14/09/2011 “Për administrimin e rrezikut të kredisë”.

Banka i ka kushtuar një vëmendje të veçantë riskut të kredisë duke zhvilluar procedura të ndryshme me anë të të cilave mund të identifikohet, vlerësohet dhe monitorohet risku i kredisë. Në strukturën e saj organizative, Banka ka zhvilluar struktura të ndryshme të cilat kanë përgjegjësi të mirëpërcaktuara qysh në fillimet e procesit të aplikimit për kredi, duke vijuar më tej me analizën dhe paraqitjen e aplikimit në komitetet përkatëse. Proçesi i analizës dhe aprovimit i nënshtrohet parimit të katër syve si nga njësitë e biznesit ashtu edhe nga ato të kreditit. Proçesi i monitorimit në vazhdimësi kryhet nga njësitë përkatëse e përmendura më sipër, si dhe nga njësia e menaxhimit të riskut për portofolin në tërësi.

Gjithashtu, Banka, me mbështetjen e Grupit, ka zhvilluar dhe njëkohësisht përdor përgjatë procesit të aprovimit të kredisë teknikat e klasifikimit të brendshëm. Më konkretisht, Banka përdor modele të klasifikimit të brendshëm për klientët e biznesit, si dhe modele të pikësimit për produktet ofruar klientëve individë.

Banka përlogarit fonde rezervë në bazë të rregullave të percaktuara në Rregulloren Nr. 62 të Bankës së Shqipërisë “Mbi Administrimin e Rrezikut të Kredisë”

Për çdo kategori të rrezikut, aplikohen normat minimale të fondeve rezervë si më poshtë:

Lloji i huasë	Norma e fondit rezervë
Standarde	1%
Në ndjekje	5%
Të ristrukturuara nga performuese (standarde dhe në ndjekje)	10%
Nën-standarde	20%
Të dyshimta	50%
Të humbura	100%

(e) Ekspozime në instrumente të Kapitalit; informacion mbi pozicionet e përfshira në librin e bankës (informacion cilësor dhe sasior).

Banka nuk ka ekspozime në instrumente të kapitalit.

(f) Risku i normës së interesit në librin e bankës

Banka ka risk nga norma e interesit nga aktiviteti i saj financiar, kryesisht në formën e ekspozimit ndaj ndryshimeve negative në normat e interesit të tregut. Asetet dhe detyrimet ndahen në grupe kohore sipas datave të tyre të rivlerësimit për instrumente të normës së interesit variabël ose sipas datës së maturimit, për instrumentet me interes fikse. Risku i normës së interesit vjen për shkak të korrelacionit jo të përsosur mes maturitetit (për normat fikse të interesit) ose datës së rikimit (për normat variable të interesit) të aseteve dhe detyrimeve që mbartin interes, lëvizja e pafavorshme e pjerrësisë dhe formës së kurbës së kthimit (lëvizja jo paralele e kthimit të normës së interesit për asetet dhe detyrimet që mbartin interes).

Aktivitetet manaxhuese të aseteve dhe detyrimeve janë kryer në kontekstin e analizës së ndryshueshmërisë ndaj ndryshimeve në normën e interesit. Banka zakonisht jep kredi me normë interesi të ndryshueshme sipas politikave të Bankës me normë të indeksuar (e cila bazohet në normat referencë si Bono Thesari, EURIBOR, LIBOR, etj.). Nga ana e depozitave, Banka ofron kryesisht produkte me normë interesi fikse. Banka është e ekspozuar ndaj një sërë risqesh të cilat lidhen me luhatjet në normat e interesit në treg për pozicionin e saj financiar dhe flukset e parave.

Banka përlogarit raportin e ndryshimit të ekspozimit në librin e bankës ndaj kapitalit rregullator të shprehur në përqindje bazuar në Udhëzimin Nr. 33, “Mbi Administrimin e Rrezikut të Normës së Interesit në Librin e Bankës”. Sipas kërkesave rregullatore, ky

raport nuk duhet të jetë më shumë se 20%. Në 3-mujorin dytë të vitit 2022 ky raport ishte 8.03% sipas tabelës më poshtë:

Forma totale e IRRBB-s		Totali i pozicioneve të ponderuara	
		Monedha	Shuma
IRR		1	2
2.	NDRYSHIMI NË VLERËN E EKSPozIMIT		596,788
3.	KAPITALI RREGULLATOR (own funds)		7,425,654
4.	(NDRYSHIMI NË VLERËN E EKSPozIMIT / KAPITALI RREGULLATOR) * 100		8.037
1.1.	monedha 1	ALL	231,546
1.2.	monedha 2	USD	14,012
1.3.	monedha 3	EUR	379,282
1.15.	-monedha 15	OTHER	-28,052

VI. KAPITALI RREGULLATOR DHE MJAFTUESHMERIA E KAPITALIT

Kapitali i autorizuar, emetuar dhe paguar plotësisht përbëhet nga 100% pjesëmarrje e Alpha Bank A.E., Athinë.

Kosto historike e kapitalit të paguar të Bankës përbëhet nga 10,080,000 USD, ekuivalent me 1,197,000 mijë Lek dhe 71,152,499 Eur ekuivalent me 9,296,785 mijë Lek.

Kapitali rregullator i bankës më 30 Qershor 2022 është 7,425,654 mijë lekë (mund t'i referoheni tabelës 13)

Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit është raporti i kapitalit rregullator mbi aktivet dhe zërat "jashtë bilancit" të ponderuara me risk, i shprehur në përqindje. Në 30 Qershor 2022 Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit është 15.73%

TABELA 13: KAPITALI RREGULLATOR

(000 lekë)

KAPITALI RREGULLATOR			
Rreshtat	Nr.	Zëri	Shuma
010	1	<u>KAPITALI RREGULLATOR</u>	7,425,654
015	1.1	KAPITAL I NIVELIT TE PARE	7,425,654
020	1.1.1	KAPITAL BAZE I NIVELIT TE PARE	7,425,654
030	1.1.1.1	Instrumenta të kapitalit të njohura si Kapital Bazë i Nivelit të Parë (KBN1)	10,960,120
040	1.1.1.1.1	Kapitali i paguar	10,960,120
130	1.1.1.2	Fitimet e pashpërndara	-2,414,526
140	1.1.1.2.1	Fitimet e pashpërndara dhe humbjet e mbartura nga periudhat e mëparshme	-2,715,588
150	1.1.1.2.2	Fitimi ushtrimor i fundit të vitit	301,062
160	1.1.1.2.3	Fitimi ushtrimor i periudhës raportuese	-365,332
200	1.1.1.3	Rezervat (përveç rezervave të rivlerësimit)	817,483
	1.1.1.4	Diferenca rivleresimi kreditore	-1,362,375
250	1.1.1.5	Rregullime të KBN1 lidhur me filtrat prudencialë	
300	1.1.1.6	(-) Emri i mirë	0
340	1.1.1.7	(-) Aktive të tjera të patrupëzuara	-209,716
350	1.1.1.7.1	(-) Shuma bruto e aktiveve të tjera të patrupëzuara	209,716
390	1.1.1.9	(-) Aktivet e fondeve të pensionit me përfitim të përcaktuar	0
440	1.1.1.11	(-) Teprica e zbritjeve nga zërat e Kapitalit Shtesë të Nivelit të Parë që tejkalojnë Kapitalin Bazë të Nivelit të Parë	0
530	1.1.2	KAPITALI SHITESI I NIVELIT TE PARE	0
750	1.2	KAPITALI I NIVELIT TE DYTE	0
760	1.2.1	Instrumentat e kapitalit dhe borxhi i varur të njohur si kapital i nivelit të dytë	0
770	1.2.1.1	Instrumenta të kapitalit të paguara plotësisht dhe borxhi i varur	0
780	1.2.1.2	Zëra memorandumi: Instrumentat e kapitalit dhe borxhi i varur jo	0

Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit	Shuma	
(në mijë lekë)		
1. Kapitali regullator	(a)	7,425,654.25
2. Aktivët dhe zërat jashtë bilancit të ponderuara me rrezik	(b)	47,218,634.46
3. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (2/1)* 100	((a)/(b))* 100	15.73%



TABELA 14: MJAFTUESHMERIA E KAPITALIT

Nr.		Zëri	Shuma (000 lekë)
010		KAPITALI RREGULLATOR	7,425,654
020		RMK (%)	15.73%
030		SHUMA TOTALE E EKSPOZIMEVE TE PONDERUARA ME RREZIK	47,218,634
		RREZIKU I KREDISE	
040	1.	Shuma e ekspozimeve të ponderuara me rrezik për rrezikun e kredisë, kundërpartisë, dhe rrezikun e shlyerjes së transaksioneve jo-DVP - Metoda Standarde (SA)	42,749,278
050	1.1	Klasat e ekspozimit sipas SA duke përjashtuar pozicionet e titullimit	42,749,278
060	1.1.1	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive qendrore ose bankave	2,366,628
070	1.1.2	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive rajonale ose autoriteteve	0
080	1.1.3	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organeve administrative dhe	0
090	1.1.4	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj bankave shumëpalëshe të	0
100	1.1.5	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organizatave ndërkombëtare;	0
110	1.1.6	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj institucioneve të mbikëqyrura;	3,289,274
120	1.1.7	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj shoqërive tregtare (korporatave);	15,363,894
130	1.1.8	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj portofoleve me pakicë (retail);	11,551,583
140	1.1.9	Ekspozime ose ekspozime të mundshme të siguruara me kolateral pasuri të	8,176,768
150	1.1.10	Ekspozime (kredi) me probleme;	717,855
160	1.1.11	Ekspozime ndaj kategorive të klasifikuara me rrezik të lartë;	633,152
170	1.1.12	Ekspozime në formën e obligacioneve të garantuara;	0
180	1.1.13	Ekspozime në formën e titujve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive SiK;	0
190	1.1.14	Zëra të tjerë	650,125
		RREZIQET E TREGUT	0
210	2.	Shuma e ekspozimeve të ponderuara me rrezik për rreziqet e tregut	0
220	2.1	Shuma e ekspozimit me rrezik për rrezikun e shlyerjes	0
250	2.2	Shuma e ekspozimit me rrezik për rrezikun e pozicionit, kursit të këmbimit	0
300	2.3	Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezik për rrezikun e përqendrimit në	0
		RREZIKU OPERACIONAL	
310	3.	Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezik për rrezikun operacional	4,469,357
320	3.1	Metoda e Treguesit Bazik (BIA)	4,469,357
330	3.2	Metoda Standarde / Standarde Alternative	0
340	4.	Shtesat për rritjen në klasat në "Veprimet me thesarin dhe transaksionet	0

Bazuar në rregulloren nr. 48, neni 10, Banka klasifikon çdo ekspozim të zërave, brenda dhe jashtë bilancit, në një nga klasat e ekspozimit si vijon:

- ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive qendrore ose bankave qendrore;
- ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive rajonale ose autoriteteve lokale;
- ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organeve administrative dhe ndërmarrjeve jo tregtare (organizatat joqeveritare/jofitimprurëse);
- ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj bankave shumëpalëshe të zhvillimit;
- ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organizatave ndërkombëtare;
- ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj institucioneve të mbikëqyrura;
- ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj shoqërive tregtare (korporatave);
- ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj portofoleve të klientëve individë (retail);
- ekspozime ose ekspozime të mundshme të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme;
- ekspozime (kredi) me probleme;
- ekspozime ndaj kategorive të klasifikuara me rrezik të lartë;
- ekspozime në formën e obligacioneve të garantuara;
- ekspozime në pozicione të krijuara nga titullimi (securitization);



- ekspozime në formën e titujve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive SIK; dhe/ose
- zëra të tjerë.

Në bazë të shkresës nr. 1997 datë 27/04/2015, Banka e Shqipërisë ka publikuar listën e ECAI të cilat mund të përdoren nga bankat për llogaritjen e ponderimit në bazë të rregullores mbi "Normën e Mjaftueshmerisë së Kapitalit".

Lista e ECAI të cilat mund të përdoren nga Banka:

1. Moody's
2. Fitch
3. Standard and Poor's
4. Japan Credit Rating (JCR)

Banka aktualisht përdor për qëllime të mjaftueshmerisë së kapitalit tre agjencitë e para të vlerësimit.

Teknikat e zbutjes së riskut të kredisë

Politika e Bankës për kolateralin është pjesë përbërëse dhe e pandarë e drejtimit të riskut të kredisë dhe dokumenti bazë për zbutjen e riskut të kredisë, i cili përcakton rregullat / kushtet e brendshme për pranimin e një lloji standard të kolateraleve, duke përfshirë gjithashtu edhe identifikimin e formave të pranueshme të kolateraleve.

Kolaterali / garancia pranohet vetëm për të mbështetur dhe siguruar kredinë dhe nuk shërben për të zëvendësuar aftësinë e kredimarrësit për të përmbushur detyrimet e tij kontraktuale. Për këtë arsye, ato duhet të vlerësohen gjatë procesit të aplikimit për kredi krahas vlerësimit të besueshmërisë / kapacitetit të huamarrësit për shlyerjen e kredisë.

Kjo politikë është në përputhje me rregulloren nr. 48 të Bankës së Shqipërisë për Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit. Banka garanton integritetin e administrimit të garancive dhe kolateraleve në funksion të zbutjes së riskut të humbjeve të kredisë.

Grupet kryesore të kolateraleve që pranon Banka janë si më poshtë:

- Kolateral Cash (mjete monetare)
- Pasuri të paluajtshme
- Letra me vlerë
- Të ardhura të arkëtueshme
- Pasuri të luajtëshme
- Garanci
- Nota premtimi
- Letra angazhimi

Banka në përputhje me Rregulloren për Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit ka në fokus disa objektiva si më poshtë:

- Të inkurajojë dhe garantojë administrim optimal;
- Të maksimizojë efektin e zbutjes të kolateralit dhe garancitë për huatë në vonesa;
- Të përcaktojë rregullat e përgjithshme për pranimin, vlerësimin, monitorimin dhe administrimin e kolateralit (mbrojtjen me mbulim) dhe garancitë (mbrojtje pa mbulim),

si dhe të përcaktojë në mënyrë të detajuar rregullat dhe kërkesat për kolateral/garanci specifike.

Rregullat për një grup të pranuar dhe standard të llojeve të kolateralit që përdoren nga Banka për aktivitete kreditimi përshkruajnë dhe përcaktojnë:

- Kushtet për zbatueshmërinë dhe ekzekutimin ligjor,
- Kushtet për procesin e vlerësimit dhe vlerat e pranuar nga Banka në fillim të procesit për lloje të caktuara kolaterali dhe,
- Kushtet për procesin e rivlerësimit.

Banka, për qëllime të zbutjes së rrezikut të kredisë, përdor kolateralin financiar si mbrojtje e financiar e kredisë. Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2022 kolateralin financiar ka qënë si më poshtë:

Mbrojtja e financiar e kredisë	Shuma (000) lek
Kolaterali Financiar	474,524,760

Rreziku i kredisë së kundërpalës (Institucionet financiare):

Risku i kredisë së kundërpalës është risku i një humbjeje financiare të Bankës nëse një klient ose palë e ngjashme që posedon një instrument financiar dështon në përmbushjen e detyrimeve kontraktore që burojnë kryesisht nga huadhënia e Bankës ndaj klientëve, institucioneve financiare ose që burojnë nga zëra të tjerë jashtë bilancit. Për arsye raportimi të drejtimit të riskut Banka konsideron dhe konsolidon të gjithë elementet e ekspozimit të kredisë ndaj riskut (risku individual i mos përmbushjes së detyrimeve, risku i sektorëve të ekonomisë si dhe risku lokal).

Banka e menaxhon ekspozimin e saj ndaj riskut të kredisë së kundërpalës periodikisht duke monitoruar nga afër limitet e kredisë kundrejt institucioneve të mbikëqyrura, qeverive qëndrore ose bankave qëndrore në përputhje me rregulloren "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave", e cila i referohet rregullores "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit".

Vlerësimi i kërkesës për kapital për rrezikun e kredisë së kundërpartisë llogaritet bazuar në Rregulloren Nr. 48, "Për Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit", kreut VI. Sipas nenit 126 pika 3 të këtij kreu, banka shqyrton nëse ka ekspozime në lidhje me elementët e mëposhtëm:

- a) instrumentet derivative mbi banak (OTC);
- b) derivativët e kredisë (vetëm në librin e tregtueshëm);
- c) marrëveshjet e riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes së titujve dhe të mallrave (commodities), transaksionet e huadhënies dhe huamarrjes së titujve dhe të mallrave (commodities);
- d) transaksionet e huadhënies me marzhe të titujve;
- e) transaksionet me afat të gjatë shlyerje.

Për tremujorin e dytë të vitit 2022 banka nuk ka ekspozime të tilla në librat e saj.

Titullzimi

Jo e zbatueshme (N/A)

VII. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qendrueshme në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

(a) Bazat e përgatitjes

Të dhënat financiare janë paraqitur në Lek, rrumbullakosur në mijëshen më të afërt përveç rasteve kur tregohet ndryshe, dhe janë përgatitur bazuar në parimin e kostos historike, përveç letrave me vlerë për tregtim të cilat janë matur me vlerën e drejtë. Monedha funksionale e Bankës është Lek.

(b) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit janë konvertuar me kursin e datës së raportimit.

Aktivitetet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj, përveç kapitalit të paguar dhe rezervave, janë konvertuar me kursin në datën e transaksionit.

Kapitali i paguar në monedhë të huaj njihet fillimisht me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Në fund të vitit konvertohet me kursin e këmbimit në atë datë. Diferencat e konvertimit njihen në rezervën e rivlerësimit e cila është pjesë e kapitalit të Bankës.

(c) Interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi njihen në bazë përlogaritjeje.

(d) Tarifa dhe komisione

Të ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet dhe tarifat lidhen me shërbimet bankare si transferimet e fondeve, aktiviteti huadhënës, tarifa e mbajtjes së llogarive dhe garancitë bankare.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet dhe tarifat njihen në momentin kur kryhen shërbimet me të cilat ato lidhen.

(e) Tatim fitimi

Banka përcakton tatimin vjetor në përputhje me legjislacionin tatimor Shqiptar. Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm vjetor, llogaritur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), që mund jetë i ndryshëm prej raportimit për qëllime rregullatore në përputhje me MRF.

Fitimi i tatueshëm ndryshon nga fitimi para tatimit sipas SNRF për shkak të zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve që janë të tatueshëm ose të zbritshëm në periudhat e ardhshme dhe zërave që nuk taten apo njihen si të zbritshëm asnjëherë. Fitimi i

tatueshëm llogaritet duke rregulluar fitimin para tatimit sipas SNRF për të ardhura dhe shpenzime të caktuara, siç kërkohet nga legjislacioni Shqiptar.

Tatimi aktual llogaritet duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e raportimit dhe merr në konsideratë çdo rregullim të tatimit të pagueshëm në lidhje me vitet e mëparshme në përputhje me legjislacionin tatimor Shqiptar.

(f) Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë kartëmonedha dhe monedha në arkë dhe gjendje të pakushtëzuara në Bankën Qendrore. Për qëllime të pasqyrës së flukseve monetare, mjetet monetare dhe ekuivalentet me to përbëhen nga mjetet monetare dhe të tjera mjete të përshkruara si më sipër si dhe nga aktive me likuiditet të lartë me maturitet origjinal tre muaj ose më pak, të cilat janë objekt i një rreziku jodomethënës të ndryshimeve në vlerë, dhe përdoren nga Banka në administrimin e angazhimeve afatshkurtra.

(g) Letra me vlerë të tregtueshme

Letra me vlerë të tregtueshme janë ato letra me vlerë të cilat Banka i ka blerë kryesisht për qëllimin e shitjes në periudhë afatshkurtër. Letrat me vlerë të tregtueshme njihen fillimisht me çmimin e tyre të përfuturit, përfshi shpenzimet dhe çdo interes të përlllogaritur. Në çdo datë raportimi letrat me vlerë maten me çmimin më të fundit të tregut. Të gjitha ndryshimet në vlerën e drejtë njihen në të ardhura apo shpenzime.

Banka rishikon klasifikimin e letrave me vlerë të tregtueshme në çdo datë bilanci. Në vijim dhe pasi janë mbajtur gjashtë muaj në këtë kategori, letrat me vlerë klasifikohen përgjithmonë nga letra me vlerë të tregtueshme në letra me vlerë të vendosjes, ose letra me vlerë të investimit dhe maten me çmimin e tregut në datën e riklasifikimit.

(h) Letrat me vlerë të vendosjes

Letrat me vlerë të vendosjes janë ato letra që Banka i ka përfutur me synim mbajtjen e tyre për një periudhë prej më shumë se gjashtë muaj, me përjashtim të atyre letrave me vlerë për të cilat Banka synon t'i posedojë deri në datën e maturimit dhe të cilat kënaqin rregullat që kanë të bëjnë me letrat me vlerë të investimit. Letrat me vlerë të vendosjes gjithashtu përfshijnë ato letra me vlerë të cilat nuk mund të regjistrohen si letra me vlerë të tregtueshme apo si letra me vlerë të investimit.

Letrat me vlerë të vendosjes regjistrohen në datën e përfuturit me çmimin e tyre të përfuturit përjashtuar shpenzimet. Në çdo datë raportimi, krijohen fonde rezervë kundrejt humbjeve kapitale të porealizuara që rezultojnë nga diferenca midis vlerës kontabël dhe çmimit të tregut të letrave me vlerë. Fitimet kapitale të porealizuara nuk regjistrohen.

(i) Letra me vlerë të investimit të mbajtura deri në maturitet

Investimet në letra me vlerë të mbajtura deri në maturitet përfshijnë bono thesari dhe obligacione qeveritare të blera me qëllimin dhe aftësinë e mbajtjes së tyre deri në maturim. Letrat me vlerë të investimit regjistrohen në ditën e blerjes dhe fillimisht maten me çmimin e përfuturit, përjashtuar shpenzimet. Në datat raportuese ato maten me kosto të amortizuar, duke i zbritur fondin rezervë për mbulimin e humbjeve që krijohet për të mbuluar rrezikun e mospërmbushjes së detyrimit nga ana e emetuesit të letrave me vlerë.



VIII. POLITIKAT E SHPERBLIMIT

Politika e shpërblimit

- I. Politika e shpërblimit synon të sigurojë barazinë e brendshme dhe konkurrencën me tregun së bashku me mirëmbajtjen, angazhimin dhe motivimin e punonjësve. Kjo politikë zbatohet për të gjithë personat e punësuar nga Banka.
- II. Organet kompetente të Bankës mbajnë përgjegjësinë për rishikimin dhe përcaktimin e pagës fikse, pagës së ndryshueshme (kur është e aplikueshme) dhe përfitimet e anëtarëve të Bordit Drejtues, si dhe të "pozicioneve të ndjeshme" sipas rekomandimeve përkatëse të Bankës.
- III. Bordi i Drejtorëve (BD) mban përgjegjësinë përfundimtare për miratimin përfundimtar të pagës fikse, pagës së ndryshueshme (sa herë që është e aplikueshme) dhe përfitimet e anëtarëve të Bordit Drejtues dhe "pozicioneve të ndjeshme" të tjera.
- IV. Në përgjithësi, struktura e shpërblimit të Bankës është kombinim i elementeve fikse dhe të ndryshueshëm (kur është e aplikueshme), si dhe të një sërë përfitimesh. Për të qenë konkurrent në treg dhe për të parandaluar riskun pertej tolerancës së lejuar nga Banka, është marrë në konsideratë ekuilibri i duhur midis elementeve fikse dhe atyre të ndryshueshme të shpërblimit.

Paga bazë

Paga bazë përfaqëson elementin fikse të shpërblimit dhe pasqyron pozicionin e individit, performancën dhe rritjen e njohurive dhe aftësive. Në rast të ndryshimeve të rëndësishme në përgjegjësinë e pozicionit ose në kushtet e tregut mund të aplikohet ndryshimi i saj.

Paga e ndryshueshme

Paga e ndryshueshme përfaqëson elementet e ndryshueshme të shpërblimit, të cilat janë fakultative dhe mund t'i referohen skemave vjetore të bonuseve dhe programeve të tjera nxitëse të cilat mund të ndryshojnë nga viti në vit. Këto lloje kompensimi, kur jepen, bazohen në performancën individuale së bashku me atë të Njesisë dhe performances së Bankës. Kompensimi i ndryshueshëm bazohet mbi 'Treguesit kryesorë të Performancës' së bashku me masat cilësore, duke përfshirë respektimin e politikave, cilësinë e shërbimit, kënaqësinë e klientit dhe zhvillimin e njerëzve.

Përfitimet

Elementet fikse dhe të ndryshueshme të shpërblimit përbëhen nga një sërë përfitimesh që ndjek trendet e tregut lokal dhe kuadrin përkatës të grupit. Përfitimet mund të lidhen me pozicione specifike bazuar në hierarkinë e tyre brenda Bankës ose mund të përfaqësojnë politikat sociale ndaj punonjësve.

Objektivat e politikës së shpërblimit:

- Lidh shpërblimin me performancën e qëndrueshme në nivel korporativ dhe individual
- Lidh pagën me performancën jo vetëm në aspektin e arritjes së objektivave financiarë, por edhe në lidhje me respektimin e kuadrit të brendshëm institucional, cilësinë, kënaqësinë e klientit dhe zhvillimin e burimeve njerëzore
- Rregullon koston e punës me prioritetet e biznesit dhe kufizimet e koston
- Tërheq dhe angazhon fuqinë punëtore të talentuar
- Siguron barazinë e brendshme dhe qëndrueshmërinë e pagës
- Lidh pagën me peshën relative të çdo pozicioni të veçantë në Bankë
- Reflekton pozicionin, aftësitë, njohuritë dhe performancën e individit
- Ndërlidh ndryshimin e pagës me ecurinë dhe zhvillimin individual

Alpha Bank Albania ka aprovuar politikën e shpërblimit ne 23 Shkurt 2017.

Drejtoria e Alpha Bank Albania është përgjegjëse për:

- miratimin e politikave të Bankës për nivelet e pagave
- miratimin e përqindjes mesatare për rishikimin e pagave (duke përfshirë përshtatjen, sipas meritave dhe sipas tregut), së bashku me buxhetin e shpenzimeve të personelit,
- finalizimin dhe miratimin e rregullimeve të pagave individuale, me përjashtim të atyre të anëtarëve të saj
- miratimin (vendimi i fundit) lidhur me rritjen e pagës jashtë ciklit ose përcaktimin e nivelit të ri të pagës jashtë ciklit.

Bordi i Drejtorëve të Alpha Bank Albania ka përgjegjësinë përfundimtare për miratimin përfundimtar të:

- Politikës së shpërblimit që siguron përputhjen me parimet, kuadrin dhe udhëzimet e shpërblimit të Grupit
- Pagës fikse, pagës së ndryshueshme (sa herë që është e aplikueshme) dhe përfitimet e anëtarëve të Bordit Drejtues dhe të tjera "pozicione të ndjeshme", sipas rekomandimeve të organeve kompetente.

Banka në bazë vjetore merr dhe përpunon të dhënat e studimit të tregut nga një agjenci e pavarur në lidhje me politikat e shpërblimit. Masat kryesore që Banka merr parasysh për

këto risqe, duke përfshirë risqet e vështira për t'u matur dhe ndikimi i tyre në pagat dhe politikat e shpërblimit.

- Masat që zbaton banka për të rregulluar politikat e shpërblimit në rast se performanca financiare është negative:

Për të marrë informacion mbi të dhënat e tregut, Banka merr pjesë në studime të ndryshme në lidhje me kompensimet dhe përfitimet të kryera nga firma konsulente me reputacion. Në këtë mënyrë realizohet qasja e menjëhershme në rezultate dhe publikimet përkatëse.

Prandaj, krahasimi i pozicioneve të punës së Alpha Bank Albania me pozicionet përkatëse në treg bëhet e lehtë, duke ofruar në të njëjtën kohë një mjet të besueshëm për ndermarrjen e veprimeve korrigjuese.

Për të siguruar konkurrencën e tregut, politika e shpërblimit rishikohet në mënyrë sistematike, sipas vlerësimit të tregut mbi kompensimet dhe përfitimet.

Rezultatet e sondazhit rishikohen për të qenë të informuar mbi tendencat e tregut dhe pozicionimin e Bankës duke u krahasuar me institucionet përkatëse.

- Informacion përmbledhës mbi mënyrat në të cilat banka lidh objektivat me performancën afatgjatë në nivelin e shpërblimit.

Vlerësimi i performancës të secilit punonjës, si rezultat i zbatimit të sistemit të vlerësimit të performancës nga Banka, ndërton një nga parametrat për llogaritjen e shpërblimit të tij /saj.

Në lidhje me vendimet për çështjet e kompensimit, merret parasysh vlerësimi i performancës në nivel Banke, Njësie dhe individuale.

Vlerësimi i performancës në lidhje me shpërblimin vendoset në një plan afatgjatë, me qëllim që të sigurohet se procesi i vlerësimit është bazuar në një performancë afatgjatë dhe se pagesa e shpërblimit në lidhje me performancën shpërndahet brenda një periudhe kohore gjatë të cilit mund të merren parasysh cikli i aktivitetit ekonomik ekzistues dhe risku i biznesit.

- Informacion mbi format e shpërblimit të ndryshueshëm që përdoren nga Banka dhe bazat e përdorimit të këtyre formave.

Paga e ndryshueshme përfaqëson elementet e ndryshueshme të shpërblimit, të cilat janë fakultative dhe mund t'i referohen skemave vjetore të bonuseve dhe programeve të tjera nxitëse të cilat mund të ndryshojnë nga viti në vit. Këto lloje kompensimi, kur jepen, bazohen në performancën individuale së bashku



me atë të Njesisë dhe performances së Bankës. Kompensimi i ndryshueshëm bazohet mbi 'Treguesit kryesorë të Performancës' së bashku me masat cilësore, duke përfshirë respektimin e politikave, cilësinë e shërbimit, kënaqësinë e klientit dhe zhvillimin e njerëzve.

- Format dhe elementët e shpërblimit për Këshillin Drejtues dhe drejtuesit ekzekutivë

Personeli me ndikim të konsiderueshëm në profilin e riskut mund të përfshihet në një skemë të ndryshueshme të shpërblimit me karakteristika të veçanta në lidhje me kohën dhe menyren e pagesës.

Rolet me një profil rreziku janë përcaktuar si më poshtë:

- Anëtarët e Këshillit Drejtues
- Anëtarët e Drejtorisë
- Kryetarët e Funksioneve të Kontrollit të Pavarur, pra:
 - Drejtimi i Riskut
 - Përputhshmëria
 - Kontrolli i Brendshëm